



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorozuar Prilijeno / Prodato Received / Delivery	14. 11. 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prijlog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHUK	7082/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.839/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.839/2022 të datës 30.09.2022 të parashtruar nga ankuesi me adrese Komuna e Skenderajt, kundër organit të punësimit Komunës së Skenderajt, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 14.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.839/2022 e datës 30.09.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. OBLIGHET Kryetari i Komunës së Skenderajt, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë plotësim ndryshim e Aktit të Emërimit të ankuesit të datës 01.10.2012 duke ia ngritur koeficientin nga 7 (shtatë) në 9 (nëntë).

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi i cili sipas shkresave të lëndës i punësuar në Komunën e Skenderajt, nëpërmjet e-mailit më datë 30.09.2022 me numër protokollit 5781/2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër përgjigjes së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të datës 24.08.2022, me pretendimin ankimor se i njëjti është duke u dëmtuar

dhe duke iu shkelur të drejtat e nëpunësit civil pasi që nuk është duke u paguar njëjtë sikurse paguhen zyrtarët e tjerë në komuna të tjera për punën e njëjtë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.10.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Skenderajt, ndërsa Këshilli më datë 27.10.2022, me numër protokolli 6500/2022, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Skenderajt, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. protokolli 5781/2022 të datës 30.09.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga I.A. për ankesa.kpmschk@rks-gov.net 30.09.2022; Kërkesë me numër protokolli 02-120/01-0043189/22 e datës 22.08.2022; Akt Emërim i A.U. me numër protokolli 112-814 i datës 01.10.2012; Kërkesë për Zhvillimin e Procedurave të rekrutimit (Konkurs i Brendshëm) për pozitën Zyrtar Çertifikues i datës 15.10.2019; Vendim mbi lejimin e shpalljes së konkursit të brendshëm për vendin e lirë të punës për pozitën Zyrtar Çertifikues në kuadër të DBF-së Komuna Skenderaj e datës 31.10.2019; Konkurs me nr. 111/01-0023564/20 i datës 01.07.2020; E-mail nga B.Z. për I.A. i datës 08.03.2021; E-mail nga I.A. për B.Z. i datës 08.03.2021; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 11.10.2022; Përgjigje në ankesë e datës 27.10.2022; Konkurs Lëvizje brenda kategorisë për pozitën Zyrtar Çertifikues i datës 02.02.2021; Detajet e Përshkrimit të Punës për pozitën Zyrtar Çertifikues; Përgjigje në kërkesë me nr. protokolli 02-120/01-0043189/22 i datës 24.08.2022; Pliko e datës 25.10.2022; E-mail nga A.F. për C.Z. i datës 08.11.2022; E-mail nga C.Z. për A.F. i datës 08.11.2022; E-mail nga A.F. për C.Z. i datës 09.11.2022; E-mail nga C.Z. për A.F. i datës

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesi sipas Akt të Emërimit me numër 112-814 të datës 01.10.2012 është i punësuar në Komunën e Skenderajt, në pozitën e punës "Zyrtar Çertifikues për Pagesa" dhe paguhet me koeficient shtatë (7). I njëjti me datë 22.08.2022 ka parashtruar kërkesë numër protokolli 02-120/01-0043189/22 tek Kryetari i Komunës së Skenderajt me pretendimin që ti ngritët koeficienti nga shtatë (7) në nëntë (9) me arsyetimin se pozita "Zyrtar Çertifikues i Pagesave" sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë është me përgjegjësi të veçanta. Ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Skenderajt me datë 24.08.2022 me numër protokolli 02-120/01-0043189/22 ka nxjerrë përgjigje në kërkesë ku e ka njoftuar ankuesin se nuk ka mjete të planifikuara buxhetore e as planifikim të personelit për zhvillimin e procedurës për pozitën "Zyrtar Çertifikues" për vitin 2022.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka gjetur se përgjigja në kërkesë me numër protokolli 02-120/01-0043189/22 të datës 24.08.2022, e cila është objekt shqyrtimi në Këshill nuk ka përmbajtur këshillën juridike siç përcaktohet me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 i Ligjit Nr. 05/L -031 për



Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Akti administrativ i shkruar përmban: pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike)...", andaj bazuar në nenin 127 paragrafi 1 dhe 3 i të njëjtit ku përcaktohet se: "1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj", dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar me datë 30.09.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është parashtruara brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me harmonizimin e koeficientit për pozitën "Zyrtar Çertifikues për Pagesa", Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, ku përcaktohet se: "Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës", si dhe nenin 3 paragrafi 2. Ligji nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ku përcaktohet se: "2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë" sikurse e ka analizuar edhe nenin 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik i cili rregulloj të drejtën të drejtën e pagës dhe shpërblimit të drejtë, e që specifikisht përcakton se: "Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave."

Po ashtu, në bazë të shkresës me numër të protokollit:6038 të datës 27.11.2014 të lëshuar nga Drejtori i DASHC-së, i Ministrisë së Administratës Publike, është konstatuar po ashtu se për pozitën "Zyrtar Çertifikues" koeficienti duhet të jetë nëntë (9), andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se organi i punësimit është i obliguar që të veprojë në pajtim me dispozitat e lart cekura ligjore, si dhe ankuesit obligohet t'i bëjë ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit, duke i ndryshuar koeficientin nga shtatë (7) duhet të bëhet nëntë (9) ngase organi i punësimit është i obliguar që të veprojë në këtë mënyrë me qëllim të zbatimit të nenin 3, paragrafi 2. Ligji nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ku përcaktohet se: "2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë", sepse në bazë të shkresës së lartcekur të Ministrisë së Administratës Publike, me nivelin e pozitës dhe përshkrimin e detyrave të punës, është konstatuar se për pozitën "Zyrtar Çertifikues për Pagesa" koeficienti duhet të jetë nëntë (9), dhe të bëhet trajtimi për të gjithë nëpunësit civil në mënyrë të barabartë që mbajnë pozitën e lartcekur, ndërsa ankuesi deri në momentin e parashtrimit të ankesës në Këshill për punën e njëjtë ka qenë duke u paguar me koeficient shtatë (7).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, thekson faktin se organi i punësimit Komuna e Skenderajt, pas pranimit të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e obliguar që ankuesit t'ia bëjë plotësim Ndryshimin e Aktit të Emërimit sipas të gjeturave në arsyetim e këtij vendimi, pra t'ia harmonizojë koeficientin sikurse është e përcaktuar për pozitën "Zyrtar Çertifikues", respektivisht duke ia ngritur nga shtatë (7) në nëntë (9), ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të bëjë ndryshimin e listës së pagave për ankuesin, gjegjësisht ankuesit procedimi i pagës duhet t'i bëhet sipas koeficientit nëntë (9) nga momenti i pranimit të këtij vendimi.




Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.839/2022

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Eshref Shabani


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Skenderajt;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Skenderajt, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

